

ANKARA (AA) - Pas suksesit të madh në zgjedhjet e mbajtura sot në Turqi, liderët botëror kanë uruar presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdo?an, për suksesin në këto zgjedhje, transmeton Anadolu Agency (AA).

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përmes linjës telefonike ka uruar presidentin Erdo?an për suksesin në zgjedhje.

Sipas burimeve presidenciale, presidenti Erdo?an falënderoi kryeministrin e Shqipërisë për urimin.

## **Hungaria**

Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orbán, u bë lideri i parë i një shteti të Bashkimit Evropian (BE), i cili uroi presidentin Erdo?an për suksesin në zgjedhje. Sipas zyrtarëve, ai uroi presidentin turk përmes linjës telefonike.

## **Azerbajxhani**

Presidenti i Azerbajxhanit, Ilham Aliyev, ka uruar presidentin turk, Recep Tayyip Erdo?an, për suksesin e madh të arritur në zgjedhjet presidenciale.

Sipas një deklarate të lëshuar nga presidenca e Azerbajxhanit mësohet se Aliyev ka telefonuar homologun e tij Erdo?an duke i uruar përgëzimet e tij për "suksesin e madh në zgjedhje".

Duke bërë të ditur se nën udhëheqjen e Erdo?an Turqia është zhvilluar më shumë, ka arritur suksese të mëdha në fushën e ekonomisë, si dhe ka forcuar pozicionin e saj në arenën ndërkombëtare, Aliyev në bisedën telefonike i ka uruar suksese të mëtejshme presidentit Erdo?an.

Ndërkohë edhe Erdo?an i ka shprehur falenderime homologut të tij Aliyev për kujdesin e treguar dhe urimet e bëra

Gjithashtu bëhet e ditur se Aliyev ka ftuar presidentin Erdo?an për një vizitë në zyrtare në Azerbajxhan, i cili e ka pranuar këtë ftesë.

## **Bosnjë dhe Hercegovina**

Kryetari i Këshillit Presidencial të Bosnjë dhe Hercegovinës, Bakir Izetbegović, uroi presidentin turk, Recep Tayyip Erdo?an, për suksesin në zgjedhje.

## **Palestina**

Presidenti i Palestinës, Mahmud Abbas, uroi presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdo?an, për suksesin në zgjedhje.

## **Katari**

Emiri i Katarit, Tamim bin Hamad al Thani, uroi presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoʻan, për suksesin në zgjedhje.

Sipas të dhënave nga zyrtarët, Al Thani i ka përcjellur presidentit Erdoʻan urimet për suksesin e arritur në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të mbajtura sot në Turqi.

### **Serbia**

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, uroi presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoʻan, për suksesin në zgjedhje.